

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GTF”

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar”
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më (12/05/2023), me cilesinë e ortakëve kemi redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në respektim te Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar.
- (2) Ne themeluesit, kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë me emërtimin **GTF SH.P.K.**:

- **Z. Neritan Selita**, i biri i Rexhepit dhe Lijes, shtetas shqiptar, datëlindjes 21.06.1978, lindur ne Klos, Mat dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. Nuci Naci, Nd. 37, H.1, Ap. 12, Njesia nr. 5, 1019, Tirane, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së se identitetit me nr. 037735270 dhe numer personal H80621137T,
- **Z. Alfred Selita**, i biri i Rexhepit dhe Lijes, shtetas shqiptar, datëlindjes 30.12.1980, lindur në Cerruje, Mat dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së se identitetit me nr. 034073298 dhe numer personal I01230113H.

Neni 2:

Objekti

- (1) Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:
 - Konsulencë e biznesit dhe menaxhimit. Konsulence ne fushen e turizmit dhe marketingut, mediateve te cdo lloji audiovizive, te internetit, te shkruara, per



- llogari te klienteve te shoqerise dhe me qellim perdorimin me efektivitet te mediave te shkruara dhe audiovizive.
- Shërbime të menaxhimit, dizenjimit dhe supervizimit të projekteve, përjashtuar projektet e ndërtimit.
 - Veprimtari marketingu, promocioni dhe distribucioni per te gjitha llojet e sherbimeve dhe mallrave per llogari te vetat, ose ne funksion te te treteve. Produkte informacioni dhe promocioni.
 - Konceptimi, organizimi dhe manaxhimi i reklamave te fushatave, eventeve, fushatave te marketingut, mardhenieve me publikun spoteve publicitare, ne fushen e desigjit, publikimeve, reklamave dhe promocionit, etj.
 - Sherbime te agjencive te udhetimit, shoqerim dhe asistence turistesh, sherbime te guidave turistike. Shitje e biletave te udhetimit dhe sherbime per paketat turistike. Operator turistik. Shërbime të udhëtimit të biznesit.
 - Sherbime per organizimin dhe menaxhimin e udhetimeve, sherbime mbeshetese per transport tokesor, ajror dhe detar
 - Pajisje video konferencash, sherbime per projektme teknike per impiantet mekanike dhe elektrike te ndertesave, sherbime per projektme te sistemeve elektrike.
 - Organizimi dhe zbatimi i fushatave promovuese, eventeve dhe evenimenteve te çdo lloji.
 - Shërbime të organizimit të ekspozitave, panairove dhe kongreseve, seminareve, eventeve, eventeve kulturore, të festivaleve, të festive, shfaqjeve të modës, panairove dhe ekspozitave,
 - Sherbime te dizajnit grafik dhe te specializuar. Shërbime botimi. Sherbime te printimit dhe te publikimit.
 - Shërbime fotografike, shërbime fotografike reklamuese, shërbime të specializuara fotografike, shërbimet fotografike në studio, shërbime të përpunimit të fotografive, shërbime të restaurimit, kopjimit dhe korrigjimit të fotografive
 - Shërbime trajnimi, shërbime të trajnimit të stafit, shërbime trajnimi të specializuara.

(2) Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Neni 3: Kohëzgjatja

- (1) Shoqëria krijohet për një afat kohor **prej 20 vitesh**. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve kohëzgjatja e shoqërisë mund të shkurtohet apo zgjatet.

Neni 4: Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Peti, Pallati Beta I, Shkalla 2, Ap. 2, Tirane.



KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1000 (njëmijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues **Neritan Selita**: zoterues i 1 (1) kuote, që përben 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortaku themelues **Alfred Selita**: zoterues i 1 (një) kuote, që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- (2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- (1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- (2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- (3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- (4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- (1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- (3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

- (1) Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- (2) Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- (3) Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- (5) Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.
- (6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- (1) Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (2) Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi



- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:
 - a) ndryshimin e statutit;
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - c) shpërndarjen e fitimeve;
 - ç) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- (3) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Përfshirja nga e drejta e votës

- (1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- (2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- (1) Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i Vetëm.



- (2) Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- (3) Administrator i Shoqërisë do të jetë:

Z. Neritan Selita, i biri i Rexhepit dhe Lijes, shtetas shqiptar, datëlindjes 21.06.1978, lindur ne Klos, Mat dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. Nuci Naci, Nd. 37, H.1, Ap. 12, Njesia nr. 5, 1019, Tirane, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 037735270 dhe numer personal H80621137T,

me specimen nënshkrimi:



- (4) Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment.
- (5) Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.

Neni 14 **Kompetencat e Administratorëve**

- (1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- (2) Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.



- (4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësia e Administratorit

- (1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- (2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- (3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- (4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- (5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- (6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- (7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



KREU IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

- (1) Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- (1) Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- (2) Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V
PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

- (1) Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- (2) Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.
- (3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- (4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- (5) Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- (1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- (1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- (2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 21

Mosmarrëveshjet


- (1) Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K E T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Neritan SELITA



Alfred SELITA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER IRMA BROCI
ADRESA Nr.11, Rruga "Don
Bosko", Kulla nr.1
TEL: 0682041600




VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 1073

Tirane më 12/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



V2023054320073065663

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DIHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER IRMA BROCI



DATE 12/05/2023
NR REP 1073

VËRTETIM NËNSHKRIMI

AKT THEMELIMI STATUT SHOQERIA "GTF" shpk

Sot, më datë 12. MAJ 2023 dymije e njezet e tre , para meje Noter IRMA BROCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.11, Rruga "Don Bosko", Kulla n r.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: Neritan Selita, atësia Rexhep, amësia Lije, shtetas Shqiptar, lindur në Klos, Mat dhe banues në TIRANË, me adresë Nuçi Naçi; Nd. 37; H. 1; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/06/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037735270 dhe nr. personal H80621137T , ,

NËNSHKRUES/IT: Alfred Selita, atësia Rexhep, amësia Lije, shtetas Shqiptar, lindur në Cerruje, Mat dhe banues në TIRANË, me adresë Nuçi Naçi; Nd. 37; H. 1; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 30/12/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034501761 dhe nr. personal I01230113H , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, " AKT THEMELIMI DHE STATUT per shoqerine " GTF" SHPK, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTERE

IRMA BROCI